**VENDIM**
**Nr.357, datë 9.4.1998**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratohet Rregullorja e Kuvendit Popullor sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.2. 2. Rregullorja e Kuvendit Popullor, e miratuar me vendimin nr.206, datë 2.7.1991, plotësuar e ndryshuar me vendimet nr.226, datë 14.5.1992; nr.234, datë 21.10.1992; nr.279, datë 8.7.1996; nr.280, datë 16.7.1996; nr.315, datë 25.7.1997 dhe nr.318, datë 30.7.1997, shfuqizohet.

Në vendimin nr.315, datë 25.7.1997, pika II, ku përcaktohen emërtimet dhe përbërja e komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve, nuk shfuqizohet me hyrjen në fuqi të rregullores së re.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datën 4.5.1998.